**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**UJESJELLES SH.A BULQIZE**

*Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania* *email.ujesjellesibulqize@gmail.com*

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr_______Prot Bulqizë,më ___/11/2020

Për: EGLAND me Adresë: Diber Shupenze ZOGJAJ Fshati Zogaj.Zyra tek ndertesa pranë fabrikës së mermerit/Zogajdhe me NIPT: J96829419D

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-76229-10-21-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës**: Rikonstruksion i Ujesjellesit Gurrat e Xhingalles Ternove e madhe.**

Publikime të mëparshme, *Nr. 74 datë 21 Shtator 2020:*

Buletini i Njoftimeve Publike ***26/10/2020, Numri 91***

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **x**

oferta ekonomikisht më e favorshme □

Hapja ofertave u be me: **02.10.2020 12:00**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. EGLAND sh.p.k me NIPT J96829419D

Vlera*: 2.294.510 ( dy milion e dyqind e nentedhjete e kater mije e peseëqind e dhjetë ) Leke pa TVSH*

*2* BOE:AMBER&CO JOGI

- J O G I me NIPT: J63229478K

- AMBER&CO me NIPT: L97325201E

Vlera *2,186,258, (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë PA TVSH*

*3. SHEHU me NIPT : J66702707S*

*Vlera:2 153 713(dy milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH*

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**BOE:AMBER&CO JOGI** arsyet e skualifikimit:

Në kriteret e veçanta të kualifikimit Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Oferta e paraqitur është nga Bashkimi I dy Operatoreve ekonomik BOE:AMBER&JOGI për këtë është paraqitur Kontratë Bashkëpunimi me Nr. Rep. 1600 Nr. Kol.710 datë 31.10.2020. Në këtë kontratë bashkëpunimi Operatorët ekonomik kanë marrë përsipër realizimin e punimeve të preventivit: JOGI 75% të punimeve, AMBER&CO 25% të punimeve.

Referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK neni 74 pika 2 citon:

Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Nga verifikimi i formularit te ofertës rezulton se BOE: JOGI& AMBER&CO nuk kanë percaktuar elementët konkretë që do të kryhen nga secili operator ekonomik.

Sa më sipër ky kriter nuk plotësohet.

Në pikën 2.2.2 për kapacitetin ekonomik dhe financiar Autoriteti Kontraktor ka vendosur kriterin e mëposhtëm:

Vertetim per xhiro mesatare vjetore për tre vitet e fundit (2017, 2018, 2019) jo më të ulët 50% e fondit limit që prokurohet.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomikë për piken 2.2.2 duhet ti plotesoje secili prej operatoreve anëtarë të bashkimit në përputhje me marrëveshjen e bashkepunimit.(sipas % të kontratës së bashkëpunimit)

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori ekonomik AMBER&CO ka paraqitur vërtetim xhiro vjetore me Nr. T03076949 Datë, 01.11.2020 i cili është për vitin 2019 në shumën 0 leke.

Sa me siper ky kriter nuk plotesohet.

Në pikën 2.3 për kapacitetin teknik Autoriteti Kontraktor ka vendosur kriterin e mëposhtëm

Punë të ngjashme për një objekt te vetëm me vlerë 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

Referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 neni 74 pika 3 citon:

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori ekonomik AMBER&CO nuk ka paraqitur punë të ngjashme.

Nga verifikimet e kryera ne dokumentacionin e paraqitur nga OE JoGi rezulton se nuk ka paraqitur asnjë dokument për Punonjës Saldator.

Nga verifikimet e kryera ne dokumentacionin e paraqitur nga OE JOGI rezulton se nuk ka paraqitur asnjë dokument për punonjes Montim tubash.

OE JOGI ka paraqitur eskavator me goma me targë AF MT 88 nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE JOGI nuk ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik për këtë mjet.

Operatori ekonomik JOGI nuk ka paraqitur dokumentacion për rimorkiator.

Operatori ekonomik JOGI nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi ose kontratë paraprake me furnizuesin Për Tuba, rakorderi, matësa uji,

Operatori ekonomik JOGI nuk ka paraqitur mostra te tubave sipas diametrit të shoqëruara me çertificatë ISO ISO 9001:2015 dhe raport testimi nga prodhuesi

Mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar neni 53, 46 Autoriteti kontraktor refuzon ofertën e paraqitur nga BOE: JOGI&AMBER &CO.

**SHEHU**

Për mjetin eskavator me goma Operatori ekonomik Shehu ka paraqitur kontratë shitblerje nuk ka paraqitur dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik SHEHU ka paraqitur Leje Qarkullimi, Certifikatë të kontrollit teknik, Siguracion dhe fotografi për Rimorkiatorin me Targë AFR 882. Certifikata e kontrollit teknik rezulton se ka skaduar ne daten 11.07.2020

Operatori ekonomik SHEHU nuk ka paraqitur mostra të tubave sipas diametrit të shoqëruara me çertifikatë ISO 9001:2015 dhe raport testimi nga prodhuesi .

Operatori ekonomik Shehu ka paraqitur Autorizim prodhuesi shoqëruar me certifikatën e cilësisë.

Nga verifikimi rezulton se certifikata e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është e perkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe. Për këtë arsye është e pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga EGLAND sh.p.k me Nipt:J96829419D , me një vlerë të përgjithshme prej *2.294.510 ( dy milion e dyqind e nentedhjete e kater mije e peseëqind e dhjetë ) Leke pa TVSH* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni në *Ujësjellësin Bulqizë* për sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e këtij publikimi por ne cdo rast subjekti është i detyruar t’i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës ne zbatim te nenit 21 te Vkm 914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës,kjo proçedure do të anullohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa: NUK KA

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **12/11/2020**

Data e publikimit te ketij njoftimi: 23**/11/2020**

**ADMINISTRATORI**
**ASLLAN DAXHA**